



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:161339
Datë: 24.03.2025
Numri i dokumentit: 07035166

AA.nr.524/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, F.V1 nga Komuna e Kaçanikut, të cilin e përfaqëson F.V2, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë- Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit dhe njohjen e të drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, përkitazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1929/2022, të datës 25.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.03.2025, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë-Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1929/2022, i datës 25.04.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1929/2022, të datës 25.04.2024, është vendosur, “I. Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësi, F.V1, si e bazuar. II. Anulohet vendimi i të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë- Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, i datës 12.07.2022, me numër të ankesës 7406 dhe vendimi i datës 03.03.2022 me numër 7406, ndërsa paditësit i njihet e drejta në kompensimin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik ne kategorinë e grupit dytë, në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh dhe atë nga data e nxjerrjes së vendimit datë 25.04.2024 e deri me datën 25.04.2027. III. Obligohet e paditura, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë- Departamenti i Pensioneve, që paditësit t’ia kompensojë në mënyrë retroaktive pagesën në emër të kompensimit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në kategorinë e dytë, gjegjësisht për periudhën kohore nga data e refuzimit të kësaj të drejte nga data 03.02.2022 në vlerën e caktuar prej 150 euro (njëqind e pesëdhjetë euro) për çdo muaj deri me datën 25.04.2027, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. IV. Udhëzohet paditësi që pas 3(tre) viteve nga momenti i njohjes së kësaj të drejte, të paraqesë kërkesë për rivlerësim mjekësorë tek e paditura, për të

vazhduar njohjen e kësaj të drejte. V. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e nulura dhe ka karakter te detyrueshëm.”

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë- Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, përmes Avokaturës Shtetërore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1929/2022, të datës 25.04.2024, ndryshohet dhe refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala paditëse.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë;28.07.2022, kundër vendimeve të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë- Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, sepse konsideron se vendimet e kundërshtuara me padi janë të pa bazuara dhe jo të ligjshëm, për arsye se nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike nga ana e organeve administrative, si dhe është zbatuar gabimisht edhe ligji material, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm dhe të miratohet kërkesa për njohjen e të drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimeve të paditurës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 43.3 dhe 67 të Ligjit për Konflikte Administrative ashtu që vendosi që vetë meritorisht ta vendosë këtë çështje administrative. Gjykata duke vlerësuar e vendimin e goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve të padisë, përgjigjes së dhënë nga e paditura ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërisht e bazuar. Me vendimin e shkallës së parë, te datës 03.02.2022, paditësit F.VI, i është refuzuar kërkesa në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Me vendimin e shkallës së dytë të MPMS-së, Departamenti i Pensioneve të datës 12.07.2022 me numër 7406, të goditur me padi, është refuzuar ankesa e paditësit në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore në grupin e parë. Nga vendimet kontestuar, del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë: “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është*

dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se: “Z/znj. F.VI, ka parashtruar ankesë më datë 08.06.2022, për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë, është vërtetuar se ankesa e tij nuk është në harmoni me nenin 7 pika 2 dhe pikën 1 të nenit 8 të Ligjit 05/L-067”. Në rastin konkret gjykata gjeti se, e paditura në arsyetimin e vendimit të atakuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, nuk ka administruar asnjë provë nga e cila mund të vërtetohet fakti se paditësi nuk i plotëson kriteret e parapara ligjore për të fituar statusin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, por vetëm ka dhënë një arsyetim të përgjithshëm duke u thirrur në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Gjykata, në të mirë të konstatimit të gjendjes faktike, me aktvendimin A.nr.1929/2022, të datës 09.01.2024, sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore, e cila i është besuar eksperteve mjekësor të certifikuar nga KGJK-ja për kryerjen e kësaj ekspertize, ku ka caktuar mjekë specialist, Dr. Zyrafete Mustafa –Ftiziater, Dr. Eliza Kastrati- Kirurg i Përgjithësim dhe Dr. Halime Gashi Behluli - Neurolog. Të njëjtët, më datë 28.02.2024, kanë përpiluar Raportin e Ekspertizës, dhe gjykata po ashtu ka ftuar ekspertët mjekësorë të deklarohen lidhur me ekspertizën në seancën e shqyrtimit kryesor, me ç’ rast kanë deklaruar se, mbetem pranë ekspertizës së dhënë pranë kësaj gjykate datë 28.02.2024, me të cilën kemi dhënë konkluzionin përfundimtar me të cilën pacienti F.VI sipas ekzaminimit të drejtpërdrejtë dhe shkresave të lëndës kemi konstatuar që hynë në kategorinë e personave paraplegjik në kategorinë e grupit të dytë të personave praplegjik dhe tetrapalgjik. Gjykata për te vlerësuar ligjshmërinë e vendimit te goditur me padi, i’u referua Ligjit 05/L-O67 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht neni 1 me të cilin është përcaktuar që “Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor”, ndërsa neni 3 par.1, nen par 1.1 me te cilin është përcaktuar që “Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme”, Po ashtu me nenin 7 paragrafi 2 i po të njëjti Ligj përcakton se: “ Përfituesit e këtij ligji, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, të cilët kanë pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë përqindë (50%) të kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni”, kurse me nenin 8 të këtij ligji përcaktohet: “1. Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji”, andaj bazuar në konstatimet si në ekspertizën mjekësore dhe provave të administruara përjashtohet humbja e ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve ashtu siç e parasheh nen 7 paragrafi 2 dhe neni 3 paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe po ashtu nuk dëshmojnë plotësimi i kushteve për aplikimin e nenit 8 paragrafi 1 i këtij ligji. Ekspertët mjekësor në ekspertizë dhe as gjatë shqyrtimit gjyqësor në asnjë fazë nuk kanë konstatuar humbjen në formë të përhershme të mundësisë së zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo të sipërme të këtu paditësit , po ashtu nuk është konstatuar se ka pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, se ka humbje të ndjeshmërisë së plotë të

ekstremiteteve, andaj edhe në këtë kuptim me ekspertizë është konstatuar se këtu paditësi hynë në kategorinë e personave paraplegjik në kategorinë e grupit të dytë të personave praplegjik dhe tetrapalgjik., në mënyrë që kjo Gjykatë të vendosë ndryshe. Për më tej, neni 4 i të njëjtit ligj përcakton se, “Përfituesit e këtij ligji mbrohen nga të gjitha llojet dhe format e diskriminimit, shfrytëzimit, abuzimit, fyerjes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të njohura nga Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë me standardet dhe parimet e përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”. Ndërsa, me Rregulloren Nr.07/2017 Për Përbërjen, Funkcionin, Përgjegjësinë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenin 5 par.1 i saj janë përcaktuar Funkzioni dhe Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues ku është paraparë që: 1. Komisioni Vlerësues ka këto funksione dhe përgjegjësi: 1.1. Ekzaminimin e parashtruesit të kërkesës; 1.2. Vlerësimin e grupimit dhe nevojave sociale të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, e cila bëhet duke u bazuar në dokumentet mjekësore, mendimin konziliar nga Klinika e Neurologjisë-QKUK, si dhe ekzaminimit nga ana e Komisionit Vlerësues; 1.3. Përfituesit e grupit të parë janë persona me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve; 1.4. Përfituesit e grupit të dytë janë persona që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve; 1.7. Përcaktimin e nevojës për kujdestar personal”. Neni 9 i po kësaj rregullore ka paraparë procedurën e Rivlerësimit ku është përcaktuar që në bazë të vlerësimit të Komisionit Vlerësues, përfituesit e grupit të parë me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve do t'i nënshtrohen rivlerësimit në çdo pesë vite, kurse për përfituesit e grupit të dytë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve rivlerësimi konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Gjykata vlerësoi secilën provë veç e veç, dhe të gjitha në lidhshmëri me njëra-tjetrën, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar pjesërisht bazuar. Në veçanti, gjykata krijoi bindjen e saj nga ekspertiza e nxjerrë nga grupi i ekspertëve të certifikuar nga KGJK-ja e datës 28.02.2024, dhe deklaramentit të ekspertëve në seancën e shqyrtimit kryesor, të cilët kanë konstatuar se paditësi sipas ekzaminimit të drejtpërdrejtë dhe shkresave të lëndës hynë në kategorinë e personave paraplegjik në grupin e dytë me, andaj i përgjigjet kategorisë së grupit të dytë të personave paraplegjik dhe tetraplegjik. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar si provë edhe vlerësimin e Komisionit mjekësorë të së paditurës, të datës 08.06.2022, mirëpo duke qenë se i njëjti nuk përmban kurrfarë sqarime dhe arsytimi lidhur me gjendjen shëndetësore të paditësit dhe nëse i njëjti ka ndryshuar ose jo, ndërsa nga shkresat e tjera të lëndës vërtetohet se gjendja e tij nuk ka ndryshuar dhe këtë fakt e vërtetoi edhe ekspertiza mjekësore e nxjerrë në procedurë gjyqësore. Nga të gjitha këto arsye, gjykata nuk mundi t'i falë besimin vlerësimit dhe konstatimit të Komisionit Mjekësorë të së paditurës, si provë e vetme sipas së cilës paditësi nuk i plotëson kriteret e parapara me nenin 7 pika 2 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Prandaj, për faktin se paditësi ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura, gjykata kërkesëpadinë e tij e aprovoi pjesërisht si të bazuar dhe si rrjedhojë e detyron të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqë vlerësoi se sa i përket mendimeve dhe vlerësimit të ekspertëve, ekspertiza është e qartë, nuk ka kontradiktoritet në vete, si dhe e paditura nuk e ka kontestuar, nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, madje e paditura nuk i është përgjigjur as ftesave në seancën e shqyrtimit kryesor. Për të gjitha këto arsye, kjo gjykatë me qëllim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, respektivisht, në respektim të nenit

6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për një proces të rregullt brenda afateve të arsyeshme, nga vlerësimi i përgjithshëm ka krijuar bindje se ekspertiza e nxjerrë nga ekspertet të certifikuar nga KJK-ja, është provë e besueshme e paanshme për të vendosur çështjen. Ndërsa gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e paditësit se i njëjti duhet ti takoj e drejta pensionit të lartcekur në grupin e parë, mirëpo faktin se paditësi nuk ka ofrua dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte në grupin e parë dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata kërkesëpadinë e tij e aprovoj pjesërisht si të pa bazuar duke ja njohur këtë pension në grupin e dytë të personave paraplegjik dhe tetrapegjik meqë vlerësoj se sa i përket mendimeve dhe vlerësimit të eksperteve, ekspertiza është e qartë, nuk ka kontradiktoritet në vete dhe për të gjitha këto arsye kjo gjykatë me qëllim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, respektivisht në respektim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për një proces të rregullt brenda afateve të arsyeshme, nga vlerësimi i përgjithshëm ka krijuar bindje se ekspertiza e nxjerrë nga ekspertet të certifikuar nga KGJK-ja, është provë e besueshme e paanshme për të vendosur çështjen dhe të njëjtës ia fali besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ndërsa, me nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ është paraparë që “Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohej edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet”. Po ashtu e paditura me vendimi e atakuar i'a ka mohuar paditësit të drejtën për shfrytëzimin e kompensimit për personat paraplegjik dhe tetrapegjik në kategorinë e dytë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, Nga kjo rezulton se paditësit në momentin e ekzekutimit të vendimit kontestues i është shkaktuar dëm ngase i njëjti nuk ka mundur të realizoj të ardhurat që kanë buruar nga e drejta në shfrytëzimin të këtij pensioni- nga data e paraqitjes se kërkesës date 03.02.2022 në kategorinë e grupit të dytë, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur me përcaktimin e lartësisë së shumës në kompensimin e personave Paraplegjik dhe Tetrapegjik përkatësisht pikës II të dispozitivit, gjykata i'u referua Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetrapegjik,. Me tej, lidhur me realizimin e kësaj të drejte – nga dita e paraqitjes se kërkesës si në pikën III të dispozitivit, gjykata ju është referuar nenit 9 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësinë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetrapegjik. Kjo gjykatë vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës, të dhëna në përgjigje, se paditësi nuk i ka plotësuar kriteret për njohjen e këtij pensioni, mirëpo, si të tilla, kjo gjykatë pasi i vlerësoi, i refuzoi si të pabazuara, pasi nuk i pa me ndikim në një vendimmarrje tjetër nga vërtetimi dhe vendosja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.”

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimit ankimor se Gjukata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndrojnë shkeljet e procedurës kontestimore, megjithatë kolegji i apelit vëren se gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se e paditura në ankesë vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi jo i drejtë e gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, me ekspertizën e nxjerrë nga gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, e datë;28.02.2024, e cila është përgatitur nga tre mjekë specialist të fushave përkatëse Dr. Zyrafete Mustafa-Fiziatër, Dr. Eliza Kastrati-Kirurg i Përgjithshëm, dhe Dr. Halime Gashi- Behluli-Neurolog, të cilët pasi kanë ekzaminuar paditësit, shkresat e lëndës, dhe sqarimeve të dhen në seancën e shqyrtimit kryesor, kanë nxjerrë përfundim se *“mbetem pranë ekspertizës së dhënë pranë kësaj gjykate datë 28.02.2024, me të cilën kemi dhënë konkluzionin përfundimtar me të cilën pacienti F.VI sipas ekzaminimit të drejtpërdrejtë dhe shkresave të lëndës kemi konstatuar që hynë në kategorinë e personave paraplegjik në kategorinë e grupit të dytë të personave praplegjik dhe tetrapalgjik.”* Kurse këtë ekspertizë nuk e ka kundërshtuar as paditësi, e as e paditura me ndonjë parashtrësë pas dorëzimit të saj me dt.26.03.2024, e as në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.25.04.2024, në të cilën kanë prezantuar mjekët, e në të cilën e paditura është thirrur në mënyrë të rregullt dhe nuk ka marrë pjesë. Prandaj, kolegji i apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, për faktin se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kolegji i apelit nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se i njëjti është i pa qëndrueshëm dhe i pa argumentuar me prova konkrete të cilat do të gjente mbështetje ligjore, dhe si i tillë është pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Gjykata e shkallës së parë, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, përkatësisht, Ligji nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, neni 3, paragrafi 1.1, dhe nenit 7, paragrafi 1.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit. Prandaj ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.524/2024, datë 18.03.2025

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti